

VENDIM
Nr. 923, datë 29.12.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 783, DATË 10.11.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E NDARJES TË TË ARDHURAVE TË TAKSËS
VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA ME NJËSITË E QEVERISJES VENDORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e vendimit nr. 783, datë 10.11.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor së bashku me drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor në varësi të saj, të caktuara me ligj si agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, deklarojnë dhe paguajnë taksën brenda datës 15 të muajit pasardhës, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit të Financave.

Për periudhën tatimore dhjetor 2014, deklarimi dhe pagesa e kësaj takse për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore bëhet brenda datës 15 janar 2015.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama